



SPECIALIST PROSECUTOR'S OFFICE
ZYRA E PROKURORIT TË SPECIALIZUAR
SPECIJALIZOVANO TUŽILAŠTVO

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-05
Prokurori i Specializuar kundër Salih Mustafës

Për: Gjykatësin e Procedurës Paraprake
Gjykatësi Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Parashtrues: Prokurori i Specializuar

Data: 22 shkurt 2021

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

**Parashtrim i dosjes paraprake të korigjuar me shtojcën 1 rreptësisht
konfidenciale dhe *ex parte* dhe shtojcën 2 konfidenciale**

Zyra e Prokurorit të Specializuar
Xhek Smith

Mbrojtësit të të akuzuarit
Julius von Bone

1. Më 15 shkurt 2021, Zyra e Prokurorit të Specializuar ('ZPS') paraqiti dosjen e procedurës paraprake së bashku me listën e dëshmitarëve dhe listën e provave materiale,¹ pasuar nga versionet e redaktuara konfidenciale të këtyre dokumenteve të protokolluara më 17 shkurt.²
2. Në formatin e numrit të regjistrimit të provës ('NRP/ERN') të dokumenteve të cituara në poshtëshënimet e dosjes paraprake u gjetën disa gabime. Në veçanti, disa poshtëshënime duhet të korrigjohen për të pasqyruar formatin specifik në të cilin NRP-ja shfaqet në sistemin elektronik *Legal Work Flow* ('LWF').³ Gjithashtu, tri referenca (NRP-të e të cilave ishin kopje identike të dokumenteve tashmë të cituara) u hoqën si të cituara gabimisht.⁴
3. Këto korrigjime nuk ndikojnë në përmbajtjen e dosjes, por janë të nevojshme për të bërë më të lehtë gjetjen e dokumenteve themelore përkatëse në sistemin elektronik LWF.
4. Si rezultat i këtyre korrigjimeve, ZPS-ja paraqet në vijim versionet e korrigjuara të:
 - a. dosjes paraprake;⁵ dhe
 - b. versionit të redaktuar konfidencial të dosjes paraprake.⁶

¹ Parashtrim i dosjes paraprake me listën e dëshmitarëve dhe listën e provave materiale, me shtojcat 1-3 rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, KSC-BC-2020-05/F00082, 15 shkurt 2021.

² Parashtrim i versioneve të redaktuara konfidenciale të dosjes paraprake, listës së dëshmitarëve dhe listës së provave materiale me shtojcat 1-3 konfidenciale, KSC-BC-2020-05/F00085, 17 shkurt 2021.

³ Për shembull, në poshtëshënimin 1, referenca SPOE00238090 është ndryshuar në SPOE00238090-00238090; në poshtëshënimin 20, referenca SPOE00055870-00055988-ET, në faqen 42, është ndryshuar në SPOE00055870-SPOE00055988-ET, f.42; në poshtëshënimin 83, referenca IT-05-87-P00444 është ndryshuar në IT-05-87 P00444 (pa vijë); në poshtëshënimin 113, referenca 060698-TR-ET Pjesa 3, f.10 është ndryshuar në 060698-TR-ET Pjesa 3 **Rishikuar** RED, f.10. Ndryshime të njëvlershme të ngjashme të formatit janë bërë në të gjitha poshtëshënimet aty ku ka qenë e nevojshme.

⁴ SPOE00127846-00127847 është hequr nga poshtëshënimi 107; SITF00071427-00072757 RED është hequr nga poshtëshënimi 108; SPOE00135052-00135775 është hequr nga poshtëshënimi 122.

⁵ Shtojca 1.

⁶ Shtojca 2.

Numri i fjalëve (në origjinal): 280

_____/nëshkrim/_____

Xhek Smith
Prokuror i Specializuar

E hënë, 22 shkurt 2021
Në Hagë, Holandë